



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 060-42560/22

Klinë, dt 21.12/22

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 26.09.2022, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkryetarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSB-së, dhe prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Siguria në Komunën e Klinës,
4. Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore,
5. Të ndryshme.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Zv.Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Theksoi që shumica e anëtarëve janë prezent dhe që mund të vazhdojnë me mbajtjen e mbledhjes.

Pika 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Zv.Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Në qoftë se ka ndokush të shtojë diçka në lidhje me procesverbalin, e keni lexuar ose kush ka pasur email në listën e nënshkrimeve i kemi përcjellë dhe me email dhe besoj që keni pasur kohë të mjaftueshme që ta lexoni, përndryshe nëse ka dikush që nuk i ka plotësuar të dhënat, i plotësoni dhe herën tjetër i përcjellim procesverbalin dhe rendin e ditës.

Pika 3. Siguria në Komunën e Klinës.

Nënkryetarja u përgjigj për kërkesat/pyetjet që janë bërë në mbledhjen e kaluar, ku filloi me pyetjen e Don Agim Qerkinaj, për vendosjen e shenjave ose shiritave në rrugë.

Zv.Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Unë nuk e di saktësisht nëse është ndërmarrë diçka për këtë por nëse ka përgjigje komandanti, atëherë ja kaloj fjalën dhe ju informon.

Komandanti z.Ragip Bytyqi: Përshëndetje dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e radhës! Sa i përket sigurisë në zonën tonë, mund të themi se zonën e kemi shumë të qetë dhe nuk kemi ndonjë incident që duhet me u përmend në këta muajt e fundit. Unë për ju kam përgatitur disa statistika të muajit gusht se çka ka ndodhur, na ka karakterizuar një numër i madh i bashkatdhetarëve, çka na ka prekur më shumë gjatë gushtit është se kemi pasur më tepër aksidente në komunikacion për shkak të numrit të madh të automjeteve dhe normalisht që numri i aksidenteve ka qenë më i dukshëm sesa muajt e tjerë.

Për muajin gusht, janë paraqitur 79 incidente në stacionin policor, 41 aksidente, 4 aksidente me lëndime trupore, 37 aksidente me dëme materiale dhe 4 persona të lënduar prej këtyre aksidenteve.

Muajin gusht, stacioni policor ka shqyrtuar 1,328 gjopa të ndryshme në komunikacion, janë arrestuar 47 persona 10 prej tyre janë ndaluar në ndalim policor, janë konfiskuar 4 armë, 113 copë municion të kalibrave të ndryshëm, kemi realizuar 4 asistime, vepra penale që janë paraqitur në stacionin policor janë 5 lëndime të lehta trupore, 2 vjedhje, 5 vjedhje të rënda dhe 5 raste të dhunës në familje, kemi realizuar diku 74 patrullime me këmbë dhe 203 patrullime me veturë.

Sa i përket pikave prej mbledhjes së kaluar që ka qenë si pikë referuese, ne, bashkë me autoritetet komunale dhe bashkë me ekspertin e komunikacionit, z. Josipin, e kemi formuar një grup punues prej 4 anëtarëve dhe e kanë përpiluar një projekt-propozim për sinjalizim horizontal dhe vertikal, në kuadrin e këtij projekti që është hartuar prej këtyre zyrtarëve mendohet edhe në pjesën përballë kishës ku është edhe ankesa e Don Agimit, besoj që Kuvendi Komunal në momentin e parë që nënshkruan kontratën dhe kemi premtime që eventualisht një muaj dy që të nënshkruhet kontrata me firmën e cila do të vendosë sinjalizimin horizontal dhe vertikal dhe këto pakënaqësi besoj që do të eliminohen. Në këtë komision kanë qenë dy inspektorë komunal, një zyrtar policor, i cili ka njohuri rreth lamisë së komunikacionit dhe inxhinieri, z.Josipi në cilësinë e ekspertit.

Zv.Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Atëherë dy përgjigjet e pyetjes paraprake i keni marrë edhe sa i përket shiritit të rrugës para Kishës edhe Josipi që pati për shenjat e komunikacionit. Kërkesë tjetër ishte edhe për patrullimin ku frekuentoheshin nxënësit më shumë, dmth afër shkollave edhe këtu komandanti dha përgjigje.

Fitim Bojaj kishte kërkesë për mirëmbajtjen e varrezave, jemi munduar edhe në atë pikë të bëjmë diçka, por e gjitha nuk është në menaxhim të komunës, pjesa tjetër i takon edhe banorëve në mënyrë të organizuar, pos rrethojave dhe pjesës tjetër që thjeshtë merret komuna. Pyetje ka pasur edhe për te lagjia “Avdijaj”, nuk e di a ka ndonjë ndryshim por shpresoj që të ketë ndryshime sa më shpejtë. Kemi Josip Dedën, në lidhje për parkingje, kemi raport që me kontratën 57-2021 rregullimi i hapësirave publike dhe parkingut d.m.th ka ndodhur një e tillë ndërtesa numër 4 në Klinë me vlerë 5,986 euro është bërë pastrimi i hapësirës nga mbeturinat dhe është shndërruar në parking, janë gjithsej 12 parkingje dhe ju shërben të gjithë banorëve të Klinës. Nëse keni dikush me u ndërlidh diçka sa i përket sigurisë në Klinë, po, Josip, urdhëro.

Z. Josip Dedaj: Faleminderit Nënkryetare, përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket sigurisë në qytetin tonë është shumë e mirë gjithmonë duke e falënderuar KFORI-in Slloven dhe Policinë e stacionit në Klinë, që shumë shpesh i vizitojnë fshatrat por i kemi dy ankesa që janë prej pas luftës, janë mbeturinat dhe qentë endacakë. E dimë që kjo varet nga niveli qendror, por që jemi të rrezikuar. Faleminderit KFOR-it, Stacionit policor për sigurinë, por faleminderit edhe për iniciativën e Drejtorisë së Inspektoratit së Komunës së Klinës edhe nga Komandanti që ne bashkë kemi dalë në terren për vendosjen e shenjave, dhe që pas 22 viteve po e bëjmë Klinën me shenja të komunikacionit.

Zv.Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit Josip, sa i përket mbeturinave, është kompania e mirëmbajtjes dhe mbledhjes së mbeturinave, ndoshta nuk është 100% efikase, por që nuk e di nëse ndonjëherë ka qenë më mirë, çdo qytetarë duhet ta mbrojë qytetin ku jeton, shohim çdo ditë dukuri jo të mira, por është e vështirë 10 me prish e 1 me ndreqë, po e përdori këtë zhargonin popullor, mirëpo mendoj që më shumë është tek vetëdijesimi sesa tek kompanitë sidomos në komunën e Klinës, që edhe në bashkësi lokale është mekanizmi i mbledhjes së mbeturinave. Sa i përket qenve endacakë, edhe për këtë kam kërkuar sqarim, e kemi kontratën e cila është me kod të caktuar operatori ekonomik është ambulanca veterinarë “Era” nga Rixheva-Klinë, deri më tani operatori ka trajtuar 268 qenë endacakë, operatori tek ordianca e tij ka 24 kafaze në të cilat pos trajtimit të tyre i mban 5 deri në 7 ditë sipas nevojës duke i ushqyer dhe trajtuar deri në shërim. Deri më tani, unë e shoh se çështja është duke u marrë seriozisht nga Komuna e Klinës dhe besoj që jemi në rrugë të mirë edhe në këtë drejtim.

Z. Josip Dedaj: Vetëm edhe diçka se ndoshta jemi keqkuptuar, kompania për pastrim për fshatin Dollc dhe Dresnik ju them një bravo të madhe, nuk është faji i tyre, është faji i qytetarëve dhe unë jua kam dhënë numrin e Policisë secilit banorë ose edhe timin, që ai person që shihet duke hedhur mbeturina të lajmërohet. Sa i përket parkingjeve, unë kam biseduar me drejtorin e Shërbimeve Publike, Qendrim Millakun, unë e kam paraqitur shqetësimin e parkingjeve që e kemi ne para shkollës fillore mbrapa sheshit “Mujë Krasniqi”, ku i kemi zyrat ne, komandant aty vijnë persona që janë të punësuar në komunë dhe jashtë komunës e që ne kemi problem që gjithë ditën e bllokojnë parkingun: Unë i thash që me vendosë një shenjë, parkingu është i bizneseve, i atyre lokaleve dhe nuk është keq me vendosë një shenjë për ndalim, aty janë mbi 30 biznese që

janë funksionale që paguajnë tatim komunal dhe nuk kanë vend ku me i parku kerret e veta. E kam shfaqur edhe herën e kaluar këtë problem, faleminderit.

Zv.Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Josip, e kam kuptuar edhe herën e kaluar edhe tash kërkesën tënde, por është shumë e pamundur të menaxhohet se kerri i kujt është, kështu që ti e kalon te unë, unë po e kaloj te Komandanti dhe besoj që çështja do të zgjidhet.

Përkthyesi z.Refki Krasniqi: Kam një pyetje konkrete për mikun Josipin, e di për cilën pjesë po flet, por kush është pronar në kadastër për atë zonë që po bisedojmë, a jeni ju a është komuna, ajo s' dihet ku është, këtë duhet me rregulluar ti ose unë se edhe unë kam pasur lokal aty dhe të njëjtin problem e kam pasur, kush është pronar me letra i asaj pjesës ku po flasim ne: Kjo është pyetja kryesore, kush është pronar i asaj pjese midis qendre aty?

Komandanti i Policisë z.Ragip Bytyqi: Mendoj që ish dashtë me biseduar me drejtorin e Shërbimeve Publike dhe për ta bërë si parking të rezervuar, nëse mendoni ju bizneset që ju pengojnë qytetarët, edhe ne duke e ditur pronën e kujt është unë besoj që ka me anë të legjislacionit me bërë parking të rezervuar, normalisht që ju parkingun e rezervuar i bëni ato pagesat e komunës dhe ai parking ka me ju lejuar vetëm juve dhe zgjidhet ai problem. Unë desha me nda një informacion me juve: ne si rajon është për t'u krenuar për bashkëpunimin që e kemi me Kuvendin Komunal të dyanshëm, Kuvendi Komunal më herët ka shprehë dëshirë për të na i dhënë disa mjete donacion sa i përket nivelit të sigurisë. Ne me anë të zyrës së Kryetarit të Kuvendit ky ka dërguar email në ministrinë adekuate dhe ka kërkuar pëlqimin prej atyre që a kemi të drejtë që stacionit Policor me ju dhënë mjete teknologjike, javën e kaluar Asambleja Komunale e ka marr një vendim që me nda një buxhet stacionit Komunal Klinë, një shumë 20,000 euro mjete teknologjike, që ndikojnë në uljen e kriminalitetit ku një ndër pikat kryesore është kjo çështja për bërlllok që ka kamera lëvizëse që do të na ndihmojnë edhe neve, dënimi e edukon qytetarin dhe mendoj që vendosja e kamerave ka me qenë ndihmë për të gjithë ne e sidomos Ragipin që është shumë i përkushtuar për nivelin e pastërtisë në qytet.

Zv Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: A dikush tjetër diçka në lidhje me temën? Unë shpresoj që Josipi e ka marr përgjigjen dhe jemi në rrugë të mirë. Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

Pika 4. Parandalimi, mbrojtja dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore.

Tema rastësisë me raste të shëmtuara që kanë ndodhur jo vetëm në komunën tonë, por në përgjithësi në Kosovë, dhe rastet e tilla na shqetësojnë dhe na bëjnë që të ndihemi të frikësuar për të rinjtë dhe të rejat. Mirëpo për t'u kthyer prapë te komandanti, ky i dha raportet, por kjo temë vlen të diskutohet vazhdimisht në çdo takim, nëse ka dikush diçka në lidhje me temën kishim diskutuar.

Komandanti i Policisë z.Ragip Bytyqi: Stacioni i Policisë në Klinë si pikë dominante e ka luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, edhe pse ne në kuadrin e Drejtorisë rajonale të Policisë në Pejë është një njësi e subspecializuar, e cila i heton këto vepra penale, sepse janë vepra që trajtohen me një përkushtim të veçantë dhe duhet të jenë njerëz të specializuar. Ne kemi nevojë për informacione sa i përket kësaj dukurie që është shumë negative. E shfrytëzoj rastin që aty ku keni informacione me dhanë informacionin aty ku duhet, sepse nëse kjo çështje identifikohet me kohë, luftohet me kohë, besoj që eliminohen të gjitha problemet dhe pasojat.

Zv.Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Shpresoj që në komunën e Klinës të mos ketë raste të tilla që na bëjnë të shqetësohemi.

Komandanti i Policisë z.Ragip Bytyqi: Sa i përket kësaj teme, është edhe Qendra për punë sociale këtu në komunën e Klinës, e cila e ka një personel të përgatitur, për dikë është shumë shqetësuese me lajmëru rastin në polici, kur ka raste të tilla ka mundësi edhe përmes Qendrës për punë sociale me njoftu, dhe normalisht janë të përgatitur me ju qas problemit njëjtë sikur ne.

Zv. Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: A ka dikush diçka tjetër, apo të kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës?

Pika 5. Të ndryshme.

Zv. Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Unë e përshëndes dhe e falënderoj për gjithë mundin, Ragip Kryeziun, të cilin e përshëndeti edhe Komandanti, e bënë thjeshtë për sensibilizim se me pastruar qytetin është punë e madhe punë e tjerëve, por ky asnjëherë nuk përton dhe në çdo aktivitet mundohet të përfshijë masën më të madhe të popullatës, unë të falënderoj personalisht dhe nëse ke diçka për të shtuar, kishim pasur dëshirë të dëgjojmë, pasi kemi kohë të mjaftueshme.

Z.Ragip Kryeziu: Faleminderit shumë, nuk e kam lehtë që të kthej përgjigje, por ka njerëz që bërllokun e gjuajnë me traktorë, e kisha propozuar që çdo njeri që ka diçka me gjuajt ta njoftojë komunën dhe të merr leje me gjuajt në një vend të caktuar ku nuk e prish ambientin. Dhe e dyta, njerëzit që e pinë cigaren, duqet mos me i gjuajt në çdo vend. Dhe diçka tjetër, keni nisë punë të reja, por jo një vend ku jam ankuar, dhe një vend që prishet duhet edhe me u ndreqë, jo me lënë ashtu.

Zv Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Punimet kanë filluar, por kanë filluar nga poshtë dhe vjen deri te pjesa e caktuar, e kam ngritur si çështje dhe besoj që patjetër që edhe ajo pjesë do të rregullohet.

Z.Josip Dedaj: Nuk e di se sa je në dijëni por dritat në fshatin Dresnik janë të projektit të OSB-së që i falënderoj, por janë diku 10 drita që nuk punojnë, kam folur edhe me drejtorin e Shërbimeve Publike, nuk e di a ka firmë kontraktuese për rregullimin e dritave nëpër qytet, por që në Dresnik janë mbi 10 drita në dy lagje që nuk punojnë, edhe asfaltimi dhe trotuari nuk e di pse nuk është duke vazhduar trotuari ajo pjesë ku është e atyre personave që s'kanë arritur me bërë kontratë me Kryetarin, ajo ka pasur mundësi për t'u vazhduar. Nënkryetare, paratë janë dhënë, projekti është implementuar, pse nuk janë duke filluar rrugët, çdo kund janë duke u punuar rrugët, ndoshta nuk je në dijëni por ta bëra pyetje?

Zv Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Josip, edhe herën e fundit të kam thënë për rrugë aty është çështje personash që komunën nuk e lejon me filluar punimet, punimet e asfaltimit janë zvarritur për shkak të rritjes së çmimeve, mirëpo me ribuxhetim dhe rikonkurrim të kompanive të tjera kanë filluar dhe janë duke punuar, ata persona duhet me lëshuar, sepse nuk rrezikohet i gjithë fshati për dy persona, unë nuk mund të jap përgjigje të saktë, me drita ka problem në gjithë qytetin, drejtori po punon në këtë drejtim dhe do të ketë zgjidhje, jo çdoherë të gjitha prishen vetë por edhe ajo pjesë do të rregullohet njëjtë si në çdo pjesë të qytetit.

Z.Josip Dedaj: Për ndriçim aty jo s'mund dora e njeriut ta prish, po janë arsye të tjera, janë të vendosura që 3-4 vite prishen edhe nga lagështia e faktorë të tjerë. Ai trotuar që ka nisur ai ka filluar të prishet, po nuk mund të them që për ata dy persona që kanë bërë pengesë nuk është fajti ta për shkak se që dy vjet ka filluar ajo kontratë me ta me gojë apo me shkrim dhe tash është ndërpre ajo rrugë aty ose është ndërpre trotuari, pse? Trotuari ka pasur mundësi me vazhduar para zgjedhjeve, por është ndërpre, e lë në faj komunën drejtpërdrejt, një arsye prej komunës së Klinës, pse për ne vendet tjera nuk ka shtrenjtim të zhavorrit apo të asfaltit?

Zv Kryesuesja z.Marqe Selmanaj: Çdo cep i Klinës është i trajtuar në mënyrën më të mirë të mundshme, nisja fillo pak me falënderime prej takimit të ardhshëm, punët e mira kanë me u bërë.

Don Agim Qerkinaj: Unë ju përgëzoj për punët e mira gjatë këtyre viteve, Klinën e shoh nga përvoja siç e njoh para 20 viteve shumë më mirë seç është, ajo çka unë dua t'i veçoj janë dy gjëra, njoftimi që të enjten që vjen do bëjmë bekimin e objektit në Deiq dhe do të fillojë me meshë dhe jeni të ftuar që të merrni ftesë. Dhe e dyta që e kisha ngritur si çështje është puna e dy parë varrezave, janë dy parë varreza që rrugët janë të shkëputura nga rruga e asfaltuar në Pogragjë dhe në Dresnik. Kjo ishte çka kisha.

Zv Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, fillimisht unë ju uroj për bekimin e meshës së parë në Kishë në Deiq, uroj mbarësi dhe paçim bekime në atë kishë dhe në çdo institucion tjetër fetar, uroj shumë që të jemi prezent çdo kush sipas mundësive të agjendave të tyre. E dyta, unë hera e parë që po e dëgjoj që nuk janë rrugët e shtruara për te varrezat, s'po di pse ka mbetur diçka e tillë, si çështje kam për ta ngritë me kuptuar pse, se jam e sigurt që s'ka mbetur rrugë pa u shtuar si te kisha dhe te xhamia, por në qoftë se ajo rrugë nuk është e


shpronësuar dhe është në emër të ndonjë qytetari, ajo rrugë nuk shtrohet, atë e dimë sipas procedurave, këtu mendoj mos është diçka kontestuese përndryshe nëse është pjesë e harresës do e shohim dhe do të merremi me të dyja rastet. Pjesa e Dresnikut a është e shtruar, a duhet renovim?

Z.Josip Dedaj: Ne vetë banorët e kemi shtruar me vetëfinancim, dhe dhashtë Zoti të merremi vesh çdo gjë që bëhet për të mirën e qytetarëve dhe Josipin e keni përkrah çdoherë.

Zv Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Unë ju falënderoj për këto që u diskutuan dhe kërkoj mirëkuptimin tuaj nëse jo gjithmonë mund t'i realizojmë, si disa që e patën mundësinë që t'i realizojnë menjëherë në takimin e radhës, por unë kërkesat e juaja do t'i adresoj tek njerëzit kompetentë. Mirë u takofshim në takimin e radhës!

Procesmbajtësja,

Orgeta Sylaj



Z.V. KRYESUESJA

Marqe Tanushi-Selmanaj



